



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07

**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 7 qershor 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

**Urdhër për Ndryshimin e Afateve për Dorëzimin e Përgjigjeve dhe  
Kundërpërgjigjeve lidhur me F00216, F00217 & F00219**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësve të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

**Mbrojtësve të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

Karl Bakli

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenin 39(13) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 9(5) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin mbi mosnxjerrjen e dokumenteve sekuestruar Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL UÇK”) më 8, 17 dhe 22 shtator 2020 (bashkërisht, “Tri Paketat”).<sup>2</sup>

2. Më 26 maj 2021 Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori vendimin (“Vendimi F00210”) mbi, ndër të tjera: (i) qasje në materiale filmike që tregojnë kontrollimin dhe sekuestrimin prej ZPS-së në ambientet e OVL UÇK-së më 25 shtator 2020 (“Materiale filmike të Kontrollimit dhe Sekuestrimit”); (ii) nxjerrjen e shënimeve bashkëkohëse që zotëron ZPS-ja të cilat iu referohen deklaratave të dhëna nga një dëshmitar ose pyetjeve të bëra një dëshmitari (“Kërkesa A e Gucatit”); dhe (iii) mosnxjerrjen e çfarëdo materiali lidhur me origjinën, burimin dhe individët që pretendohet të kenë bërë nxjerrjen e Tri Pakove (“Kërkesat B-C të Gucatit”).<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00141, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Nxjerrjen e Disa Dokumenteve Sekuestruar Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së*, 23 shkurt 2021, konfidencial.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00210, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07-F00210 në bazë të nenit 45(2) dhe rregullës 77(1); Kërkesë Alternative për Rishikim sipas rregullës 79(1)*, 3 qershor 2021, konfidencial.

3. Më 3 qershor 2021, Mbrojtja e Hysni Gucatit ("Z. Gucati") parashtroi një kërkesë për leje për apel, ose për rishikim të Vendimit F00210, lidhur me Kërkesat B-C të Gucatit ("Kërkesa e Gucatit").<sup>4</sup>

4. Më 3 qershor 2021, Mbrojtja e z. Gucati kërkoi qartësimin e Vendimit F00210 lidhur me Kërkesën A të Gucatit ("Kërkesa e Gucatit për Qartësim").<sup>5</sup>

5. Më 3 qershor 2021, Mbrojtja e Nasim Haradinajt ("z. Haradinajt") parashtroi kërkesën për leje për apelim të Vendimit F00210, lidhur me Materialin filmik të Kontrollimit dhe Sekuestrimit dhe Kërkesat B-C të Gucatit, dhe iu bashkua kërkesës për rishikim të lartpërmendur të Mbrojtjes së Gucatit ("Kërkesa e Haradinajt").<sup>6</sup>

## II. DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me rregullën 9(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të zgjasë ose shkurtojë *proprio motu* afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej Panelit.

7. Në përputhje me rregullën 76 të Rregullores, përgjigjja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh, kurse kundërpërgjigjja ndaj përgjigjes dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes.

---

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00216, Mbrojtja e z. Gucati, *Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2020-07-F00210 në bazë të nenit 45(2) dhe rregullës 77(1); Kërkesë Alternative për Rishikim sipas rregullës 79(1)*, 3 qershor 2021, konfidencial.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00217, Mbrojtja e z. Gucati, *Mocion për Qartësim të Vendimit KSC-BC-2020-07-F00213*, 3 qershor 2021, konfidencial.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00219, Mbrojtja e z. Haradinajt, *Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Kërkesat dhe Kundërshtimet në bazë të F00172*, 3 qershor 2021, konfidenciale.

### III. DISKUTIM

8. Duke mbajtur parasysh kalendarin e procedurës paraprake dhe pasojat që kërkesat e lartpërmendura mund të kenë për të, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të shkurtojë afatin lidhur me kundërpërgjigje dhe përgjigje sikurse përcaktohet në rregullën 76 të Rregullores.

### IV. VENDIMI

9. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **URDHËRON** ZPS-në të përgjigjet, lidhur me Kërkesën e Gucatit, Kërkesën e Gucatit për Qartësim dhe Kërkesën e Haradinajt , në qoftë se dëshiron, deri të **enjten, 10 qershor 2021;** dhe
- b. **URDHËRON** Mbrojtjen të kundërpërgjigjet lidhur me përgjigjet e ZPS-së ndaj kërkesave të lartpërmendura, në qoftë se dëshiron, deri **të hënë, 14 qershor 2021.**

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E hënë, 7 qershor 2021

Në Hagë, Holandë.